



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 619, Datë 09.05.2019

**“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të sipërmarrjes së përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 09.05.2019, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.

**Baza Ligjore:** Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2; 10; 12, neni 24, germa d; dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Mbi procedurat e thjeshtuara për trajtimin e disa përqendrimeve” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit në lidhje me krijimin e një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.

**VËREN SE :**

**Procedura dhe transaksioni**

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar dokumentacioni përkatës në lidhje me transaksionin që konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të

plota (joint venture) nga shoqëritë Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.

**Daimler AG**, është një shoqëri aksionare e regjistruar në regjistrin tregtar të Shtutgartit, themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit Gjerman. Daimler së bashku me filialet e saj, është një prodhues lider global i automjeteve luksoze për pasagjerë dhe tregtie me një prani të fortë në industrinë e automjeteve elektrike.

Daimler AG realizon shitje nëpërmjet përfaqësuesit zyrtar të Mercedes Benz në Shqipëri, shoqërisë Auto Star Albania SHA.

**Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd** është një shoqëri aksionare e regjistruar në Republikën Popullore të Kinës. Geely është një prodhues kinez lider i makinave në fusha të ndryshme biznesi të lidhur me biznese me prani të fortë në industrinë e automjeteve elektrike.

Shoqëria (Joint Venture), e quajtur **Smart Automobile Co., Ltd** do të jetë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Republikës Popullore të Kinës.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10, pika b) dhe nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

### **Vlerësimi i përqendrimit**

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shitjes së automjeteve dhe pjesëve të këmbimit por duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionin si edhe duke iu referuar praktikave më të mira të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës mund të lihet i hapur. Për analizimin e këtij rasti treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i njoftuar është krijimi i një shoqërie të përbashkët JV me funksione të plota nga Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group CO., LTD.

Tregu shqiptar nuk do të preket nga transaksioni i propozuar, pasi shoqëria JV nuk ka për qëllim të kryejnë në të ardhmen e parashikueshme ndonjë aktivitet në Shqipëri, prandaj Transaksioni i propozuar nuk ka asnjë impakt për konkurrencën në tregun e brendshëm.

Pas transaksionit nuk do të ketë asnjë ndryshim në strukturën e tregut përkatës në Shqipëri

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një sipërmarrje të re, të përbashkët, me funksione të plota (joint venture ) nga shoqëritë Daimler AG dhe Zhejiang Geely Holding Group Co.,Ltd.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I KONKURRENCËS**